

VENDIM
Nr. 606, datë 5.9.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 707, DATË 12.10.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI APO NË PËRDORIM TË KOMUNËS DAJÇ
TË QARKUT TË LEZHËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të komunës Dajç, bashkëlidhur vendimit nr. 707, datë 12.10.2012 të Këshillit të Ministrave, shtohet lista me 1 (një) fletë, që përfundon me numër rendor 2 (dy), e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dajç e qarkut të Lezhës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha